

URDHËR
Nr. 1595, datë 31.7.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE DHE ÇAKTIMIN E DETYRAVE
ZËVENDËSMINISTRIT TË MBROJTJES, ZNJ. PRANVERA SKANA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe të vendimit nr. 518, datë 25.9.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mbrojtjes, zëvendësministrit të Mbrojtjes, znj. Pranvera Skana, me porosi, në rastin e mungesës afatshkurtër, për ushtrimin e kompetencave në fushat e përgjegjësisë, si më poshtë:

- a) arsimin ushtarak;
- b) bashkëpunimin civilo-ushtarak;
- c) inovacionin.

2. Në ushtrimin e kompetencave të deleguara sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të ndjekë, monitorojë dhe koordinojë veprimtarinë e institucioneve të varësisë, agjencive autonome dhe drejtorive në përbërje të ministrisë, si dhe të përgjigjet përpara ministrit, lidhur me:

- a) hartimin dhe zbatimin e politikave në fushat e deleguara të përgjegjësisë, përfshirë negocimin dhe implementimin e marrëveshjeve ndërinstitutionale;
- b) zhvillimin dhe zbatimin e politikave për nxitjen e inovacionit në funksion të arsimit ushtarak dhe mbrojtjes civile;
- c) koordinimin e politikave që lidhen me zhvillimin institucional dhe teknologjik në funksion të fushave të deleguara sipas këtij urdhri;
- ç) orientimin dhe harmonizimin e politikave për fushat e deleguara të përgjegjësisë.

3. Në ushtrimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë mbikëqyrjen e performancës dhe raportimet periodike të institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome.

4. Zëvendësministri raporton me shkrim te ministri për zbatimin e detyrave të caktuara në këtë urdhër sipas kërkesës së ministrit dhe të paktën 1 (një) herë në javë për detyrat dhe përgjegjësitë e deleguara sipas këtij urdhri dhe ato të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

5. Zëvendësministri, sipas parashikimeve të këtij urdhri, autorizohet të nënshkruajë:

- a) akte shkresore të iniciuara në nivel zëvendësministri brenda fushave të përgjegjësisë, si dhe ato në përmbushje të marrëveshjeve të nënshkruara;
- b) akte shkresore që lidhen me plotësimin e detyrimeve që rrjedhin në cilësinë e tij të anëtarit apo kryetarit të grupeve të punës;
- c) çdo shkresë/akt/procedurë shkresore tjetër me autorizim të posaçëm të ministrit.

6. Kompetencat e deleguara sipas këtij urdhri ushtrohen në përputhje me ndarjen e fushave të përgjegjësisë të përcaktuara për zëvendësministrat e tjerë të Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Çdo akt tjetër që vjen në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.
 8. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegates ose të deleguar.
 9. Ngarkohen zëvendësministrja, znj. Pranvera Skana, institucionet e varësisë, agjencitë autonome dhe drejtoritë e aparatit në përbërje të Ministrisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij urdhri, sipas njoftimeve përkatëse për mungesën afatshkurtër të ministrit.
 10. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Ermal Nufi